



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhe, më _____._____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Sherbimi i konsulences me objekt: Hartimi i planit për menaxhimin e transportit në territorin e Bashkisë Lezhë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71311200-3.

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,311,000 (tete milion e treqind e njemdhjetë mijë) Lek pa Tvsh

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ veçanta të kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe si dhe VKM nr. 225 datë 12.04.2021 “Për një ndryshim në vendimin nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumentave standarte”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatoret Ekonomike duhet të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 "Për QKB" i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Meqenese operatoret ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

ose

b-Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Përvoja e mëparshme është element shumë i rëndësishëm që garanton autoritetin kontraktor, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të kete te punësuar mesatarisht të paktën 5 (pese) punonjës për periudhen Maj 2026 – Korrik 2026.

Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar;
- b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë: Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhen e kërkuar, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është nje prove bindese per

AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marrë në konsideratë se shërbimet që kërkohej të kryhen janë për punime të shtrira në territor. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të Referencës. Numri i përcaktuar është si rezultat i analizës së volumit të shërbimit, afatit të kontratës dhe organizimit minimal të nevojshëm për realizimin e saj. Ky kriter është në proporcion me objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës

2.3.3 Ofertuesi duhet të disponojë të punësuar në stafin teknik si më poshtë:

a. Inxhinier Transporti/ Mekanik / Urbanistik	2 (dy)	Diplome Universitare
b. Inxhinier Elektronik / Informatike	2 (dy)	Diplome Universitare
c. Inxhinier Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, Kontrata e punës si dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Maj 2026 – Korrik 2026. Për këtë si dëshmi duhet të dorëzohen listëpagesat perkatese.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës perkatese të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afateve të ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Prania e stafit teknik për afatit e kërkuar në listëpagesa i vërteton AK se operatori ekonomik ka një staf të qëndrueshëm, operativ i cili do të kryejë shërbimin në kohë dhe cilesi.

Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është kompleks dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i procedurës përfshin aktivitete të specializuara, të cilat kërkojnë drejtim teknik nga një specialist i fushës. Për këtë arsye, vlerësohet se prania e stafit inxhinierik të fushës është kusht minimal dhe proporcional me objektin e kontratës. Stafi Inxhinierik sipas fushave të mësipërme garanton dhe është përgjegjës i organizimit teknik të punimeve; metodologjisë që do të ndiqet për mbledhjen e të dhënave; do të koordinojë punën e ekipeve në terren.

2.3.4 Ofertuesi duhet të disponoje staf teknik mbështetës si më poshtë:

Në përputhje me natyrën multidisiplinare të studimit (analizë territoriale,urvejime, modelim trafiku, plan ndërhyrjesh/investimesh dhe komponenti i mobilitetit të ekipi minimal i ekspertëve kryesorë që duhet të disponohen me kontratë angazhimi nga operatorët konkurrues përfshin 7 (shtatë) ekspertë kyç

Sasia	Eksperti	Kualifikim minimal	Përvojë minimale	Kërkesa specifike
1	Drejtues Ekipi / Ekspert Kryesor i Planifikimit të Transportit	Inxhinier Transporti / Mekanik / Urbanistik ose fushë e ngjashme, Diplomë Master Shkence	Min. 10 vjet përvojë profesionale	Të paktën 2 (dy) studime trafiku/mobiliteti të ngjashme, realizuara si Drejtues Ekipi ose Ekspert Kryesor, në 10 vitet e fundit.
1	Inxhinier Trafiku / Modelues Trafiku	Diplomë Master në Inxhinieri Transporti / Trafiku, ose në Inxhinieri Mekanike / Rrugore / Ndërtimi / tjetër fushë inxhinierike të ngjashme	Min. 7 vjet përvojë profesionale.	Përvojë e dëshmuar në ndërtim modelesh trafiku me software të specializuar TransCAD; të paktën 1 model trafiku urban i realizuar;
1	Specialist GIS / AutoCAD	Inxhinier / Informatikë me specializim GIS	Min. 5 vjet përvojë profesionale	Përvojë e dëshmuar në hartografim GIS, harta tematike dhe përpunim CAD për studime infrastrukturë/urbanistike
1	Ekspert Ekonomist / Financiar Investimesh	Ekonomist, Diplomë Master Shkence (Financë/Ekonomiks)	Min. 5 vjet përvojë profesionale	Përvojë në vlerësim financiar dhe kosto-përfitim të projekteve infrastrukturë; hartim planesh investimesh të fazuara në kohë
1	Drejtues iurvejimeve (Trafik & Sondazhe)	Inxhinier Trafiku / Statistikë / Sociologji / Elektronik	Min. 5 vjet përvojë profesionale	Përvojë e dëshmuar në organizimurvejimesh O-D, intervista në familje dhe numërime trafiku; hartim pyetësorësh dhe trajnim intervistuesish
1	Ekspert i Sigurisë Rrugore dhe Sinjalistikës	Inxhinier Rrugor / Trafiku / Elektronik	Min. 5 vjet përvojë profesionale	Përvojë në auditim sigurie rrugore dhe vlerësim/projektim sinjalistike horizontale-vertikale
1	Ekspert i	Inxhinier Ndërtimi /	Min. 5 vjet	Përvojë e dëshmuar në hartimin e

Sasia	Eksperti	Kualifikim minimal	Përvojë minimale	Kërkesa specifike
	Mobilitetit të Qëndrueshëm	Mjedisi / Urbanist / Planifikues Territori, Diplomë Master Shkence	përvojë profesionale	Planeve të Mobilitetit Urban të Qëndrueshëm (SUMP) ose studime të ngjashme; përvojë në mobilitet aktiv (këmbësorë / biçikleta) dhe elektromobilitet.

Pranohet ekuivalenca e mëposhtme për pozicionin e Inxhinierit të Trafikut/Modelues Trafiku (dhe, sipas rastit, për pozicione të tjera teknike ku zbatohet i njëjti problem i tregut):

- Diplomë Master Shkence / profesionale në Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Rrugore / Ndërtimi, per përpunime me software edhe Inxhinieri Elektronike /Informatike ose fushë tjetër inxhinierike të ngjashme, pranohet si ekuivalente me diplomën në Inxhinieri Transporti/Trafiku;
- Përvoja specifike duhet vërtetuar me të paktën dy (2) nga dokumentet e mëposhtme:
 - (i) letër/certifikatë reference nga porositësi (autoritet kontraktues ose konsulent kryesor) që konfirmon shprehimisht rolin e kandidatit si ekspert/inxhinier trafiku në kontratën përkatëse;
 - (ii) faqja e nënshkrimeve/autorësisë në një studim ose raport trafiku/mobiliteti të realizuar më parë, ku kandidati figuron si autor ose bashkautor i pjesës teknike;
- Certifikatë trajnimi profesional në software ose metodologji modelimi trafiku (p.sh. TransCAD, ose ekuivalente);
- Kontratë pune/shërbimi me përshkrim të qartë të detyrave në fushën e trafikut/transportit;

Si dëshmi për stafin e mësipërm të paraqiten dokumentet si Diploma, dokumentacionin e sipërcituar për eksperiencën, certificate trajnimi, Kontrata e punës/shërbimit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe Shtojces 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit, ndersa dokumentacioni i kerkuar si deshmi duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimit.

Argumentimi. Ky kriter është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion stafin e nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit i cili nga natyra është komplekse dhe kërkon staf të kualifikuar me diplomën përkatëse dhe eksperiencën në këtë fushë. Objekti i kontratës konsiston në realizimin e planit të transportit në Bashkinë Lezhe. Shërbimi përfshin mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, analizimin, interpretimin dhe dixhitalizimin e informacionit, analizave statistikore dhe raporteve teknike. Për shkak të shtrirjes territoriale, volumit të punës dhe afatit të realizimit, aktivitetet duhet të zhvillohen paralelisht në disa zona, duke kërkuar angazhimin e një stafi të mjaftueshëm profesional.

Këta specialistë janë të domosdoshëm për organizimin dhe koordinimin e punës në terren, realizimin e matjeve dhe regjistrimin dhe administrimin e të dhënave, kontrollin e saktësisë së tyre dhe përpunimin paraprak të informacionit.

Eshte parashikuar edhe mundësia që stafi i mesiperm sipas të mund të sigurohet edhe nepermjet kontrates se punes apo kontrates se sherbimit per kete kontrate. Kjo rrit konkurencen dhe siguron gare te barabarte.

2.3.5 OE duhet të ketë në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi pajisjet dhe mjetet të dëshmuara me fatura pronësie, kontrata qiraje/shërbimi ose licenca software-i si me poshtë:

Nr.	Pajisje / Mjet	Sasi min.	Argumentimi, Qëllimi i përdorimit
1	Pajisje automatike numërimi / klasifikimi trafiku (tuba pneumatikë, radar ose video-analitikë)	3	Matje automatike 24/7 në stacionet hyrëse-dalëse të qytetit
2	Kamera video regjistrimi trafiku (portative, me bateri të qëndrueshme)	3	Numërim manual/klasifikim trafiku në kryqëzime dhe verifikim i matjeve automatike
3	Software modelimi trafiku i licencuar (TransCAD ose ekuivalent)	1 licencë aktive	Ndërtimi i modelit të trafikut urban 'Do Nothing' / 'Do Something' dhe parashikimet 2030
4	Software GIS (ArcGIS/QGIS) dhe AutoCAD/Civil 3D	1 licenca aktive për ekipin GIS/CAD	Hartografim, georeferencim, prodhim planimetrisht dhe planesh investimesh
5	Pajisje GPS / GNSS (handheld ose të integruara në tablet / smartphone)	3	Georeferencimi iurvejimeve në terren dhe i inspektimit të sinjalistikës
6	Rrota matëse / instrumente matje distancash dhe gjerësie karrexhate	2	Inspektimi teknik i rrjetit rrugor dhe sinjalistikës horizontale/vertikale
7	Automjete për ekipet eurvejimit në terren (lejeqarkullimi, taksa, siguracion, kolaudim)	2	Lëvizja e ekipeve të intervistuesve/numëruesve në stacionet dhe zonat eurvejimit
8	Aplikacion / Survey dixhital për mbledhje të dhënash në terren (mobile survey tool / google form)	1	Rritja e cilësisë dhe shpejtësisë së përpunimit të intervistave në familje dheurvejimeve O-D

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhes të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet

te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i paisjeve dhe mjeteve ne pronesi/qira/kontrate bashkepunimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar sherbimit sipas standardeve dhe termave te refernces, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së kontrates. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese plan pune me kronogram, qasje ndaj çështjeve të Termave të Referencës dhe plan i detajuarurvejimesh.

Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Ky kriter vendoset bazuar ne termat e references dhe zerat e preventivit te sherbimeve qe do te realizohen dhe rendesise se vecante te objektit te prokurimit. Njesia e Prokurimit thekson se opertoret ekonomike duhet te hartojne nje plan pune me kronogram, qasje ndaj çështjeve të Termave të Referencës dhe plan i detajuarurvejimesh me qellim detajimin e metodologjise qe do te ndiqet ne realizimin e sherbimit ne perputhje me termat e refernces dhe afatin e kontrates.

2.3.7 Operoret Ekonomike ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, konkretisht:

- **ISO 9001:2015**, mbi “Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalentin e saj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” i ndryshuar. Referuar natyrës së veçantë, vendndodhjes dhe përmasave të objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

Njesia përgjegjëse ka hartuar termat e references, në të cilat theksohet se janë shprehur qartë kërkesat AK për cilësinë e të gjithë shërbimit për realizimin e kontratës.

Po ashtu Njesia përgjegjëse thekson se në specifikimet teknike/termat e references nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJËSIA E PROKURIMIT